



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**RAPORTI I CILËSISË SË AJRIT NË KOMUNËN E  
PRISHTINËS**  
për muajin Prill, 2016

## Përmbajtja

Qëllimi i Pilot Projektit.....	3
Zgjedhja e lokacioneve dhe fokusimi .....	4
Paraqitja grafike e lokacioneve .....	5
Informacionet më të detajizuara sipas lagjeve .....	6
Raporti i cilësisë së ajrit në Komunën e Prishtinës për muajin Prill - 2016.	7
Vlerësimet dhe supozimet .....	7
Rekomandimet .....	9
Përfundimi .....	9

## Qëllimi i Pilot Projektit

Komuna e Prishtinës, përmes Pilotimit të Projektit për Matjen e Cilësisë së ajrit, ka për qëllim që të mundëson mbledhjen, azhurnimin dhe përpunimin e rezultateve të monitorimit automatik në kohë reale të cilësisë së ajrit, të informojë qytetarët mbi gjendjen momentale të cilësisë së ajrit përmes 10 parametrave matës si dhe të ofron vlerësim rreth masave që duhet të ndërmerren për të ngritur nivelin e cilësisë së ajrit.

**Baza ligjore** – Kompetencat vetanake të Komunës në mbrojtjen e mjedisit lokal, sipas Ligjit Nr. 03/L-04 për Vetqeverisjen Lokale; Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr.03/L-160, U.A nr.15/2010 mbi shtrirjen e rrjetit dhe U.A. Nr. 02/2011 për normat e zbatuara për monitorimin e cilësisë së ajrit.

Parametrat Matës	Njësia Matëse
Temperatura	(°C)
Monoksidi I Karbonit (CO)	(mg/m3)
Amoniumi (NH3)	(mg/m3)
Sulfuri I Hidrogjenit (H2S)	(ug/m3)
Dioksidi I Sulfurit (SO2)	(ug/m3)
Dioksidi I Azotit (NO2)	(ug/m3)
Dioksidi I Karbonit * (CO2)	(ppm)
Radiacioni	(uSv/h)
Pluhuri 2.5M/Vit	(ug/m3)
Zhurma	(db)

- *CO2 (Dioksidi i Karbonit) nuk parashifet të matet sipas Ligjit dhe Rregulloreve për mbrojtjen e ajrit nga se është përbërës themelor i ajrit. Ky është parametër i cili ndikon në një ose mënyre tjetër në mjedis (ngrohje globale) dhe sensorët e vendosur nga Komuna e Prishtinës kanë mundësi të bëjnë këtë matje. Përkundër që ne kemi vazhduar të bëjmë matjet e Dioksidit të Karbonit jemi të vetëdijshëm se ky ndotës matet në vendburim (p.sh. kur bëhet kontrollimi teknik i automjeteve, në oxhaqet ku bëhet lirimi i gazit etj.), nga arsyeja se lirimi i tij kryesisht bëhet nga djegja e lëndëve djegëse. Komuna e Prishtinës është e interesuar që të vazhdoj me matjen e këtij ndotësi me qëllim të nxitjes sa më të madhe të zgjerimit të rrjetit të ngrohjes së qytetit me projektin e kogjenerimit.*

Komuna e Prishtinës përmes këtij Pilot Projekti nuk e ka intencë marrjen e rolit të MMPH ose të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, por vetëm pasqyrimin e cilësisë së ajrit me dëshirë që të ndikojë në vetëdijesimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të ndikimit në përmirësimin e kualitetit të cilësisë të ajrit përmes masave (projekteve) konkrete të Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me MMPH dhe Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit.

Komuna e Prishtinës në Dhjetor të vitit të kaluar, në Paris ka marrë pjesë dhe e ka nënshkruar deklaratën në Konferencën Ndërkombëtare për politikën në luftimin e ndryshimeve klimatike (COP 21), prandaj edhe ky pilot projekt është në mbështetje të kësaj deklaratë dhe të koalicionit “Compact of Mayors”, ku 400 qytete janë zotuar për veprime konkrete në këtë drejtim e ndër këto edhe qyteti I Prishtinës.

## Zgjedhja e lokacioneve dhe fokusimi

Fokusi kryesor është i përqëndruar në këto tri objektiva:


- Matjen e cilësisë së ajrit në rrugë të ngarkuara
- Matjen e cilësisë së ajrit brenda lagjeve
- Lëvizja e ndotjes nga burimi në vende tjera

Zgjedhja e lokacioneve është bërë duke ju referuar kritereve të lartëcekura si dhe objektivave të projektit. Nga gjashtë paisje monitoruese, katër prej tyre janë vendosur në brendësi të lagjeve, ndërsa dy të tjera janë vendosur në rrugët e ngarkuara. Me këtë, supozohet të arrihet një rezultat i cili do të paraqes gjendjen e cilësisë së ajrit në rrugët kryesore dhe si ato mund të ndryshojnë në brendësi të lagjeve.

Gjithsej 6 (gjashtë) sensorë për matjen e ndotjes së ajrit janë vendosur në këto lagje të Prishtinës:

- |                    |                         |
|--------------------|-------------------------|
| 1. Bregu i Diellit | - Rr. Enver Maloku      |
| 2. Ulpiana         | - Rr. Mujë Krasniqi     |
| 3. Kodra e Trimave | - Rr. Vëllazërit Fazliu |
| 4. Dodona          | - Rr. Afrim Loxha       |
| 5. Dardania        | - Rr. Ilaz Kodra        |
| 6. Qendra          | - Sheshi Zahir Pajaziti |

## Paraqitja grafike e lokacioneve



Prishtinë, Maj 2016

Informacionet më të detajzuara sipas lagjeve:

	Lagjet e Kryeqytetit ku janë të vendosura sensorët					
	Bregu i Diellit Rr. Enver Maloku	Ulpiana Rr. Mujë Krasniqi	Kodra e Trimave Rr. Vëllazërit Fazliu	Dodona Rr. Afrim Loxha	Dardania Rr. Ilaz Kodra	Qendra Sheshi Zahir Pajaziti
Rëndësia e rrugës	Lidhshmeri direkte (Qender qyteti-Rruga B)	Lidhshmeri direkte (Fontana-Qender qytetit)	Lidhshmeri direkte (Besiane- Prishtine)	Lidhshmeri (Parku i qytetit - Velani)	Lidhshmeri direkte (Termokos- Tunell/Kurriz)	Rruge e ndaluar per qarkullim
Ngarkesa (mesatarja 12:00;15:00;17:00/h)	22 vetura/minut	9 vetura/minut	28 vetura/minut	5 vetura/minut	13 vetura/minut	0
Burimi permanent i ndotjes	Shtëpi, Banesa, inst. Shkollore, Mbeturinat	Ndërtesa, Mbeturina	Shtëpi, Bujqesi	Shtëpi, Mbeturina	Ndërtesa, Mbeturina,	Ndërtesa, Mbeturina,
Burimi i përkohshëm i ndotjes	Automjete, Transport Publik	Automjete	Automjete, Transport Publik, Mallrave	Automjete	Automjete	
Lëvizja e erës	Levizje e hapur (kryesisht Veri-Perendim)	Levizje e hapur (kryesisht Veri- Perendim-Lindje)	Levizje e hapur (kryesisht Veri- Jug)	Levizje e hapur (te gjitha drejtimet)	Levizje e hapur (kryesisht Veri- Jug)	Levizje e hapur (te gjitha drejtimet)
Lartësia mbidetare	653 m	608 m	677 m	604 m	574 m	589 m
Latituda	42.651262	42.65145	42.674668	42.664508	42.652057	42.660219
Longituda	21.169382	21.162224	21.164352	21.170236	21.155515	21.160941

## Raporti i cilësisë së ajrit në Komunën e Prishtinës për muajin Prill - 2016

Në këtë raport pasqyrohet gjendja e cilësisë së ajrit për komunën e Prishtinës. Këto matje janë të realizuara nga gjashtë (6) stacione të cilat janë të vendosura në pjesët e ndryshme të qytetit, të përshkruara më lartë. Llogaritjet e vlerave janë si rezultat i matjeve ditore të cilat kryhen dhe interpretohen në mënyre digjitale nga sensorët.

Interpretimi i të dhënave bëhet tri herë në ditë në sistemin online, ku si rrjedhojë nxjerët mesatarja ditore e cila përfshinë matjet e mëngjesit, mesditës dhe mbrëmjes.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rezultatet mesatare të matjeve të cilësisë së ajrit për 10 parametra në të gjashtë lagjet e Prishtinës. Të përfshira janë edhe parametrat matës me njësitë e tyre si dhe vlerat e lejuara nga Bashkimi Evropian (kolona e fundit).

Parametrat Matës	Njësia Matëse	Bregu I Diellit	Dodona	Dardania	Ulpiane	Qender (sheshi)	Kodra e Trimave	Niveli I lejuar sipas BE
Temperatura	(°C)	18.22	18.22	18.22	18.22	18.22	18.22	
Monoksidi I Karbonit	(mg/m3)	0.13	1.58	7.01	1.59	2.36	1.19	10
Amoniumi	(mg/m3)	0.08	0.49	0.65	0.49	0.07	0.27	14
Sulfuri I Hidrogjenit	(ug/m3)	13.92	144.59	176.61	105.84	144.12	152.63	150
Dioksidi I Sulfurit	(ug/m3)	5.34	158.13	289.19	212.54	62.12	83.17	350
Dioksidi I Azotit	(ug/m3)	9.16	54.8	164.87	103.82	62.42	72.87	200
Dioksidi I Karbonit	(ppm)	402.13	401.16	402.36	400.13	403.12	401.17	500
Radiacioni	(uSv/h)	0.06	0.20	0.10	0.21	0.18	0.07	10
Pluhuri 2.5M/Vit	(ug/m3)	13.15	10.13	11.69	12.1	10.7	11.3	25
Zhurma	(db)	57.9	61.5	59.45	60.13	59.7	58.19	85

<sup>1</sup>BE (Bashkimi Evropian)

### Vlerësimet dhe supozimet

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme, mund të konkludojmë se rezultatet e matjeve për muajin Prill nuk janë tragjike, por gjithsesi shqetësuese. Tejkallimet e ndotjes janë të paraqitura vetëm në dy raste (në Dardani dhe Kodrën e Trimave me Sulfur Hidrogjen), ndërsa në kufi të ndotjes janë Qendra e qytetit dhe lagja Dodona me po të njëjtin ndotës.

Krahasuar ndotjen e ajrit sipas lagjeve, atëherë vërehet se lagja Dardania është lagja më e ndotur, ndërsa lagja Bregu I Diellit më e pastër. Diferencat në ndotjen e ajrit janë të vogla në mes lagjeve.

Rezultatet nga raporti tregojnë se lagja Dardania është kryesisht e rrezikuar me rritjen e Sulfurit të hidrogjenit (H<sub>2</sub>S), Dioksidit të Sulfurit (SO<sub>2</sub>), oksideve të Azotit si dhe zhurmës. Të gjithë këto parametra ende nuk i kalojnë kufijtë e lejuar por kanë tendencë të rritjes.

Si shkaktarët kryesor të ndotjes së ajrit në lagjen Dardania, supozohen të jenë djegjet e lëndëve djegëse ose transporti rrugor (lagja Dardania paraqet një nga hyrjet në qytet më të frekuentuar nga komunat tjera, sikurse që shërben edhe si lagje transiti).

Lagja Bregu i Diellit është e ndotur nga grimcat e pluhurit por ende mbrenda kufijëve të lejuar si rezultat i qarkullimit të automjeteve të bartjes së materialit dhe mbeturinave inerte nga vendpunishtet e shumta në lagjen Mati. Një nga masat mbrojtëse vlerësohet të jetë kontrollimi i këtij transporti.

Lagja Dodona ka nivel më të lartë të zhurmës, si shkak i transportit rrugor por edhe si rezultat i mungesës së pjesëve të gjelbruara.



## Rekomandimet

Për të ndikuar në ngritjen e nivelit të cilësisë së ajrit në Komunën e Prishtinës, rekomandohen këto masa:

1. Ulja e numrit të automjeteve, përmes nxitjes së transportit publik kundrejt atij privat
2. Menagjimi i rrjetit rrugor
3. Përmirësimi i transportit publik
4. Promovimi i teknologjive të pastërta
5. Nxitja e çiklizmit
6. Këmbimi i sipërfaqeve të gjelbra
7. Kontrollimi i cilësisë së lëndëve djegëse
8. Bizneset të cilat përdorin lëndë djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të paisen me LMK (përmirësimi i ventilimit dhe cilësisë së lëndës djegëse).

## Përfundimi

Ky është raporti i parë pas implementimit të Pilot Projektit për matjen e ndotjes së ajrit në Komunën e Prishtinës. Raporte të këtilla do të ketë edhe në të ardhmen, por që raportet do të bazohen në rezultatet kuartale (tremujore). Raporti i radhës parashifet të publikohet në Korrik të këtij viti për tremujorin e dytë (Prill, Maj dhe Qershor). Raportimet do të shqyrtohen dhe diskutohen edhe MMPH, Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe me IHMK. Zgjerimi i rrjetit të sensorëve në lagjet tjera të Prishtinës është paraparë pas përfundimit të fazës pilotuese të këtij projekti (gjatë vitit 2017). Çdo raport do të publikohet edhe në web faqet e Komunës së Prishtinës (<https://kk.rks-gov.net/prishtina/>) dhe (<http://prishtinaonline.com/>)